



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:261608
Datë: 29.11.2024
Numri i dokumentit: 06526659

C.nr.1711/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.M.nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Ismajli – avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Ndërmarrja T. sh.a, me seli në M., me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar, jashtë seancës gjyqësore, me datë 11.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit E.M.nga M., me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Ndërmarrja T.sh.a, me seli në M., që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar për më shumë se ... vite përvojë pune, t’ia paguajë dy paga mujore në shumë prej .€.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi E.M.nga M., përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datë ..., ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate, kundër paditurës Ndërmarrja T. sh.a, me seli në M., me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar. Në padi, paditësi ka theksuar se i

njëjti ka mbi ... vite përvojë pune te e paditura, dhe se tre muajt e fundit sa ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, i njëjti ka pasur pagën në lartësi prej ...€, andaj duke u bazuar në dispozitën e nenit 52 të marrëveshjes së lartëcekur dhe në faktin se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj për kompensimin e paditësit pavarësisht kërkesës së këtij të fundit, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e tij ta aprovoj si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën Ndërmarrja T. sh.a, me seli në Mitrovicë, që paditësit, në emër të shpërblimit jubila për më shumë se ...vite përvojë pune, t'ia paguajë dy paga mujore në shumë prej ...€, si dhe shpenzimet e procedurës të cilat i ka specifikuar si në vijim: në emër të përpilimit të padisë shumë prej ...€, në emër të taksës gjyqësore shumë prej ..€, në emër të përfaqësimit për çdo seancë gjyqësore shumë prej ...€, si dhe çdo shpenzim tjetër eventual i cili do të krijohet në këtë procedurë.

E paditura në përgjigje në padi, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe ka skaduar më datë 31.12.2017, dhe se e njëjta nuk është vazhduar më sipas nenit 81 par.2 të MPK-së, sepse Oda Ekonomike e Kosovës është tërhequr, duke konsideruar se kërkesa e paditësit është parashkuar konform nenit 87 të Ligjit të Punës, e duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë, për çka edhe të njëjtën e refuzoi në tërësi si të pabazuar.

Gjykata gjen se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura por kontestues ishte fakti se atij i takon kompensimi në emër të shpërblimit jubilar.

Nga kërkesa me nr.... e datës ..., gjykata vërtetoi faktin se paditësi ndër të tjera te e paditura ka paraqitur kërkesë për kompensimin e dy pagave jubilarë.

Nga vërtetimi me nr. të protokollit ... i datës ..., të lëshuar nga këtu e paditura, rezulton se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën më datë ... dhe kjo marrëdhënie ka zgjatur deri më datë ... kur edhe është shkëputur, dhe pastaj e njëjta është ripërtërirë përsëri më datë ... dhe nga ajo kohë paditësi dhe e paditura vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune.

Nga kontrata e punës me nr....., e datës ..., rezulton se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën, dhe mban pozitën e punëtorit të rojës.

Nga listat e pagave për paditësin, për periudhën kohore rezulton se në muajin Tetor, paga e paditësit ka qenë ...€, në muajin Nëntor ka qenë ...€, ndërsa për muajin Dhjetor nuk ka të dhëna se sa ka qenë paga e paditësit.

Provave të lartcekura gjykata i'u falë besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se me dispozitën e nenit 52 par.1, nënpar.1.2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), e cila ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, është përcaktuar se: *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij”*.

Zbatimi i marrëveshjes të lartëcekur, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 40/2023 të datës 27.02.2023, i cili ka përcaktuar se marrëveshja në fjalë aplikohet për periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri më datë 31.12.2017.

Në kuptim të nenit 399 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilin parashihet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, e duke u bazuar në pikën VI të Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.40/2023 të datës 27.02.2023, i cili ka përcaktuar se: *“I punësuari në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet*

në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik dhe përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit.”, vërtetoi se paditësi është punësuar te e paditura në vitin . dhe ka punuar aty deri në vitin 1990, që nënkupton se për këtë periudhë kohore nuk e ka arritur vitin jubilar të punësimit prej 10 vite. Pastaj paditësi është kthyer në punë te e paditura më datë dhe nga ajo kohë është në marrëdhënie pune me të paditurën, andaj duke u nisur nga kjo rezulton se për paditësin viti jubilar i punësimit për ...vjet ka arritur më datë ... ndërsa viti jubilar i punësimit për 20 vjet ka arritur më datë, dhe në asnjërin nga këto periudha kohore nuk ka gjetur aplikim marrëveshja në fjalë, andaj mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, mirëpo duke qenë se gjykata e refuzoi kërkesën e paditësit në tërësi si të pabazuar, vlerësoi se është e panevojshme që të lëshohet edhe në vlerësimin e këtij pretendimi.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të dispozitës së nenit 450, lidhur me nenin 463 par.1 të LPK, duke qenë se pala paditëse nuk e ka fituar kontestin, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1711/2021 më datë 11.11.2024

G j y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.